REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 1064 Prot

Maliq, më 19.2.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 10, datë 19.02.2026

Për

"Miratimin e Raportit të III-të të Monitorimit të buxhetit për vitin 2025"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*"pika c, si dhe neni 54 pika dh "*Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak*", ligjit 9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqipërisë"*, ligjit 68/2017 *"Për financat e qeverisjes vendore"*, udhëzimit nr 22, datë 30.07.2018 *"Për proçedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, pika 13, propozoj miratimin e këtij projekt-vendimi nga këshilli duke vendosur :

1. Të miratojë raportin e III-të të monitorimit të buxhetit për vitin 2025, sipas tabelave shoqëruese.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

Konceptoi:Nëp.Finance	G.Rrapo	Dt. 19/02/2026
Pranoi: Përgj.Sektori	M.Shaholli	Dt. 19/02/2026
Miratoi: Drejtor i Drejtorisë	A.Muka	Dt. 19/02/2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT VITI 2025

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 48, "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor",Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 22 datë 30.07.2018 "Për proçedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive tëVetëqeverisjes Vendore", i paraqitim Grupit për Menaxhim dhe Strategji në bashki "Raportin e II-të për monitorimin e zbatimit të buxhetit për 8-mujorin e vitit 2025.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshte:

- *Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*
- *Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore",i ndryshuar*
- *Ligjin nr.68 /2017"Për financat e vetqeverisjes vendore"*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise" të ndryshuar.*
- Ligjin nr. 97/2023 " Për buxhetin e vitit 2024"
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomise nr.2, dt 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025".*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr 129, datë 26.12.2024 "Për miratimin e numrit të punonjësve;nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera"*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr 130, datë 26.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025"dhe vendimin nr.4 datë 31.01.2025 "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025 të Bashkisë Maliq" si dhe vendimet e këshillit të marra për periudhën vjetor të vitit 2025, për ndryshime gjatë zbatimit të buxhetit.*

Raporti paraqet punën e administratës të Bashkisë Maliq dhe strukturave ndihmëse në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Bashkisë si në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë, ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një rritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara ndaj komunitetit.
Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë Maliq për periudhën vjetore është realizuar duke zbatuar me korrektësi ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet e këshillit bashkiak për miratimin e tij dhe ndryshimet gjatë vitit 2025.

MISIONI I BASHKISË MALIQ

Bazuar në ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", misioni i bashkisë është sigurimi i një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndryshme ,ushtrimit efektiv të funksioneve dhe kompetencave që ka bashkia duke realizuar shërbime cilësore në përputhje me kërkesat që ka komuniteti, gjithashtu të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie.

OBJEKTIVAT E BASHKISË MALIQ PËR VITIN 2025 janë:

1.Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomiko social, si në zonën urbane dhe atë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore dhe rritjen e konkurrueshmërise rajonale të Bashkisë Maliq.
2.Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës vendore dhe rajonale për të rritur e përmirësuar akset rrugore në boshtet kryesore, duke përmirësuar shërbimet ndaj komunitetit dhe turizmit në zonat malore.
3.Mbështetja maksimale në fushën e arsimit, shendetësisë, kulturës dhe sportit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre fushave prioritare.
4.Rritja e cilësisë të shërbimeve në të gjitha njësitë administrative, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve atje ku ata banojnë.
5.Rritja e transparencës dhe mirëpërdorimi i fondeve publike në dobi të komunitetit.

Raporti i III-të i monitorimit përmban :

Aneksi nr.1 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve";

Aneksi nr.2 "Raporti i shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë";

Aneksi nr.3 "Raporti i realizimit të produkteve të programit";

Aneksi nr.4 "Raporti i realizimit të objektivave të programit";

Aneksi nr.5 "Raporti i investimeve me financim të brëndshëm";

"Pasqyra e treguesve financiarë"

Buxheti i Bashkisë Maliq funksionon me 13 programe si me poshtë:

1. **01110 Planifikim,menaxhim dhe administrim**
2. **03140 Sherbimet policore**
3. **03280 Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri**
4. **04240 Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitje Kullimit**
5. **04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave**
6. **04520 Rrjeti rrugor rural**
7. **05100 Menaxhimi i mbetjeve**
8. **06260 Shërbimet publike vendore**
9. **06370 Furnizimi me ujë**

10. 08220 Shërbimet kulturore
11. 09120 Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë
12. 09230 Arsimi i mesëm dhe i përgjithshëm
13. 10430 Ndihma ekonomike dhe paaftësia

Raporti i të ardhurave sipas zërave

Tabela përmbledhëse e realizimit të të ardhurave sipas zërave për vitin 2025

Nr	Emërtimi	viti 2024			viti 2025		
		Plan vjetor	Fakt	%	Plan vjetor	Fakt	%
	Të ardhura tatimore						
1	Taksë Ndërtese	22 192	13 873	63%	22 624	13 450	59%
2	Taksë Trualli	2 719	3 230	119%	2 592	2 341	90 %
3	Taksë Toke	51 289	27 386	53%	51 111	23 313	46%
4	Taksë tabele	425	762	179%	2 548	1 260	49%
5	Taksë Tregu	600	338	56%	320	342	107%
6	Taksë Ndikimi në infrastrukturë dhe ndërtime të reja	15 000	9 011	60%	15 000	14 159	94%
7	Tatim i thjeshtuar	250	331	132%	350	166	47%
8	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.	15 500	18 448	119%	18 500	20 839	113%
9	Taksë mbi Rentën Minerare	500	307	61%	250	241	96%
10	Të ardhura nga ASHK	700	4	1%	10	1 050	10500%
11	Të Ardhura nga Qiraja	6 520	11 459	176%	8 211	12 845	156%
12	Tatim mbi TAP	13 000	18 499	142%	16 000	21 649	135%
13	Lejë për shitje me pakicë të karburanteve	5 400	3 600	67%	8 000	7 260	91%
	Shuma I	**134 095**	**107248**	**80%**	**145 516**	**118 915**	**82%**
	Të ardhura jo tatimore						
1	Tarifë Pastrimi	49 268	27 169	55%	58 186	28 415	49%
2	Tarifë Ndricimi	19 171	8 642	45%	21 950	8 397	38%
3	Tarifë Gjelberimi	3 734	2 307	62%	4 068	2 330	57%
4	Regjistrim Automjete në Bashki	279	373	134%	379	296	78%
5	Tarifë Parkimi	696	647	93%	713	630	88%
6	Tarifa të ndryshme në Bashki	2 500	1 009	40%	2 100	1 118	53%
7	Kullotat	200	206	103%	200	61	31%
8	Të ardhura nga drutë e Zjarrit.	60 000	3	0%	36 000	0	
9	Mjete Korrëse	150	130	87%	130	105	81%
10	Tarifë Uji për uitje	11 200	2 258	20%	11 310	870	8%
11	Tarifë per mirembajtje kanale kulluese	5 877	2288	39%	4 794	1 972	41%
12	Tarifë për MirëmbajtjeVarrezash	7341	3725	51%	9 676	3 297	34%
13	Bileta sporti, Kulture, udhëtimi	210	135	64%	210	115	55%

14	Tarifa Administrative	148	647	437%	151	380	252%
15	Kazan Rakije	60	10	17%	0	0	
16	Leja Non Stop	165	30	18%	0	0	
17	Gjoba të ndryshme	1200	744	62%	1 010	751	74%
18	Tarifë mjedisore	1910	1580	83%	1 511	1 686	112%
19	Tarifë për mbrojtje nga zjarri	70	91	130%	1 000	118	12%
20	Sponsorizime	0	9569		0	1 716	
21	Tarifë për linjat	2 150	800	37%	1 000	400	40%
22	Grande ngaQarku	0	473	0	0	14 585	
23	Shitje skrapi	0	264	0	0	0	
24	Tarifë për Zënie Hapësirë Publike	100	108	108%	146	74	51%
26	Dividend	0	485	0	0	0	
	Shuma II	166 429	63 693	38%	154 534	67 316	44%
	Shuma I+II	300 524	170 941	57%	300 050	186 231	62%
	TOTALI	300 524	170941	57%	300 050	186 231	62%

Të ardhurat për vitin 2025 u realizuan në shumën ***186 231 mijë*** **lekë** , ose 62 % të planit.

Të ardhurat tatimore për vitin 2025 u realizuan në shumën ***118 915 mijë lekë,*** ose 82% të planit të vitit 2025. Krahasuar me vitin 2024 të ardhurat kanë pësuar një rritje prej ***11 667 mijë*** lekë.

Në këtë grup të ardhurash, peshën kryesore e zë "*Taksa e Pasurisë sëPaluajtshme*" me një realizim të ardhurash prej 39 104 mijë lekë, ose 51% ndaj planit,"*Taksë ndikimi në infrastrukturë dhe ndërtime të reja*" me një realizim prej 94% ndaj planit ,"*Të ardhura nga qiraja*" me një realizim të ardhurash në masën 156% ndaj planit , zëri "*Tatim mbi të ardhurat personale*" i cili është realizuar në masën 135% si dhe zëri "*Taksa vjetore e mjeteve të përdorura*" që është realizuar në masën 113%.

Të ardhurat jotatimore për vitin 2025 u realizuan në shumën **67 316 mijë lekë**, ose 44 % të planit vjetor me një rritje prej 3 623 mijë lekë krahasuar vitin 2024.

Në këtë grup të ardhurash, peshën kryesore e zë "Tarifa e pastrimit" me një realizim prej 28 415 mijë lekë ose 49% të planit vjetor, "Tarifa e ndriçimit" që është realizuar në masën 8 397 mijë lekë ose 38% të planit vjetor, "Tarifa e gjelberimit" që është realizuar në masën 57%, "Tarifë mirëmbajtje kanalesh kulluese që është realizuar në masën 41% dhe tarifa për mirëmbajtje varrezash që është realizuar në masën 34%.

Nënvizojmë faktin se të ardhurat e vitit 2025 janë realizuar në masën 62 % ndaj planit me një rritje të ardhurash prej **15 290** mijë lekë krahasuar me vitin 2024.Të ardhurat në Bashkinë Maliq kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Megjithatë duhet të theksojmë faktin se gjatë proçesit të mbledhjes të të

ardhurave , problem kryesor që hasim, është ulja e numrit të familjeve rezidente si rezultat i largimit të familjeve(Brenda ose jashtë vendit) duke ndikuar në realizimin e të ardhurave për grupin familjar, duke rritur riskun për mbledhjen e detyrimeve të tyre.

Raporti i shpenzimeve sipas programeve

Referuar ANEKSIT nr. 1*"Raporti i shpenzimeve sipas programeve"* për vitin 2025.

Shpenzimet faktike në fund të vitit 2025 janë realizuar në shumën 1,490,866 mijë lekë, ose realizuar 95 % ku ndikim më të madh në mos realizim ka tek programi 01110 për shkak të mospërfundimit të punimeve në objekte. Realizim të ulët kemi dhe tek programi 09120 Arsimi Parashkollor, që janë fonde të parealizuar në shpenzime për paga dhe sigurime për shkak të vendeve vakante dhe punimeve të papërfunduara në objekte shkollore.

Po të analizojmë planin fillestar të buxhetit dhe planin e rishikuar gjatë vitit jane bërë ndryshimet në buxhet si më poshtë:

-Për arsye të akordimit të fondit nga Këshilli i Qarkut në vlerën 585,365 lekë për projektin ''Mbrojtja dhe përfshirja sociale për të moshuarit''shtesë tek programi 01110 .

-Shtesë fondi nga organizata UNDP në vlerën 1,715,500 lekë tek programi 01110 për projektin '' Qëndra ditore për fëmije''

-Pakësim të programit 03280 në vlerën 1,200,000 lekë miratuar me VKB nr.21, datë 08.02.2025, konfirmuar me shkresë nr.263/1, datë 17.03.2025 dhe shtesë në programin 04520.

-Tek Agjencia për Shërbimin Publik kemi bërë një pakësim tek programi 06260 Shërbimi Publik në vlerën 600,000 dhe shtesë tek programi 08220 për aktivitetin ''Festa e madhe e këngës''.

-Pakësim tek programi 04520 me vlerë 543,000 lekë dhe shtesë tek programi 01110 për objektin''Kolaudim ujësjellësi Mançurisht'', miratuar me VKB nr.54, dt 30.05.2025, konfirmuar me shkresë nr 520/1 prot,dt 13.06.2025.

-Me VKB nr.67,datë 30.06.2025, konfirmuar me shkresë nr.604/1,datë 09.07.2025 kemi bërë një pakësim tek programi 0 1110 për paga dhe sigurime dhe shtese tek programi 0 6260 për paga dhe sigurime në vlerën 1,880,000 lekë.

-Kemi një pakësim tek programi 09120 me vlerë 2,406,000 lekë dhe shtim tek programi 01110 për bashkëfinancim në objektin''Përmirësim i banesave për komunitete të varfra dhe në nevojë'', miratuar me VKB nr.79, dt.30.06.2025, konfirmuar me shkresë nr.604, dt 09.07.2025

-Pakësim tek programi 4520 me vlerë 1,200,000 lekë në objektin''Riparim ura'' dhe shtim tek programi 01110 në projekte, miratuar me VKB nr.130, dt 26.12.2024,konfirmuar me shkresë nr.793/1 datë 03.09.2025.

-Me VKB nr.130, datë 26.12.2024, konfirmuar me shkresë nr.38,datë 10.01.2025 kemi bërë një pakësim tek programi 09120 për paga dhe shtesë për shperblim dalje në pension në vlerën 93,480 lekë.

-Në programin 04260 kemi një pakësim me vlerë 55,000 lekë tek pagat dhe shtesë për shpërblim për dalje në pension, miratuar me VKB nr.130, dt 26.12.2024, konfirmuar me shkresë nr.38 datë 10.01.2025.

- Në programin 06260 kemi një pakësim me vlerë 89,500 lekë tek pagat dhe shtesë për shpërblim për dalje në pension, miratuar me VKB nr.130, dt 26.12.2024, konfirmuar me shkresë nr.38 datë 10.01.2025.

- Me VKB nr.130, datë 26.12.2024, konfirmuar me shkresë nr.38, datë 10.01.2025 kemi bërë një pakësim tek programi 01110 për paga dhe sigurime në vlerën 87,525 lekë, pakesim tek shpenzimet operative në vlerën 67,726 lekë, pakësim në investime në vlerën 38,400 lekë dhe shtese për transferime të tjera korrentë në vlerën 193,651 lekë.

-Në programin 04960 kemi një pakësim me vlerë 357,500 lekë tek llogaria 604 dhe shtesë për projekt ''Ndërtim ushqyes,vepra ujore'', miratuar me VKB nr.116, dt 30.09.2025, konfirmuar me shkresë nr.914/1 datë 09.10.2025.

- Pakësim tek programi 04960 me vlerë 9,488,000 lekë në llogarinë 604 dhe shtim tek programi 03280 në vlerën 7,688,000 lekë për paga, sigurime dhe shpërblime dhe në vlerën 1,800,000 lekë për blerje veshje zjarrduruese, miratuar me VKB nr.128, dt 31.10.2025, konfirmuar me shkresë nr.1012/1 datë 12.11.2025.

- Me VKB nr.130, datë 26.12.2024, konfirmuar me shkresë nr.38, datë 10.01.2025 kemi bërë një pakësim tek programi 03140 për paga në vlerën 50,000 lekë dhe shtese për ndihmë të menjëhershme në vlerën 50,000 lekë.

- Në programin 04980 kemi një pakësim me vlerë 350,000 lekë tek fondi rezerve dhe shtesë për transferta për klubin e futbollit Maliq, miratuar me VKB nr.130, dt 26.12.2024, konfirmuar me shkresë nr.38 datë 10.01.2025.

-Pakësim tek programi 08220 me vlerë 400,000 lekë për blerje veshje popullore në llogarine 602 dhe shtesë tek llogaria 231 , miratuar me VKB nr.130, dt 26.12.2024, konfirmuar me shkresë nr.38/1 datë 10.01.2025.

Me VKB nr.157, datë 24.12.2025, konfirmuar me shkresë nr.1180/1, datë 30.12.2025 kemi bërë një pakësim tek programi 04960 për llogarinë 604 në vlerën 10,705,481 lekë dhe shtese në programin 04520 investime për projektin ''Sistemim asfaltim rrugë viti 2024 në vlerën 5,705,481 lekë dhe shtesë për projektin ''Sistemim asfaltim rrugë viti 2024 F II në vlerën 5,000,000 lekë.

Referuar ANEKSIT 2 *"Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve"*, jep shpenzimet të grupuara sipas artikujve për të gjithë programet.

1.Shpenzimet korente janë realizuar në shumën 735,680 mijë lekë ose 80%, krahasuar me vitin 2024 me 110,3 % , ku ndikim më të madh ketu kanë shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe transfertat për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë.

Grupi i shpenzimeve kapitale është realizuar në shumën 153,668 mijë lekë ose 57.2 %, krahasuar me vitin 2024 me 124 %.

Programi 01110 ***" Planifikim, menaxhim dhe administrim"***

Objektivat:

1.Zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;

2.Realizimi i shërbimeve të prokurimeve publike në kohë dhe me cilësi;

3.Realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore;

4.Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit vjetor, mirëmenaxhimi i fondeve publike dhe menaxhimi i të ardhurave;

5.Ruajtja dhe mirë administrimi i dokumentacionit dhe aseteve të Bashkisë;

6.Sigurimi i qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës të qytetarëve dhe puneve publike brenda territorit të Bashkisë si dhe ekzekutimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak;

7.Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore, mbështetja e shërbimeve për blegtorinë, kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorit;

8.Planifikimi,zhvillimi dhe kontrolli mbi territorin.

Këto shpenzime janë planifikuar në funksion të realizimit të objektivave që ka Bashkia për këtë program ku futen shpenzimet për funksionimin e strukturave të Drejtorisë së Financës, Drejtorisë të

të Ardhurave,Drejtorisë së Bujqësisë, DJBNJPP, DPKZHT, IMT, Njësitë Administrative dhe strukturat mbështetëse të Kryetarit të Bashkisë.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve në programi 01110 vihet re se shpenzimet janë realizuar në masën 103% me vlerë 344,372 mijë lekë, krahasuar me vitin 2024 me 168 %

Programi 03140 Shërbimet policore

Objektivat:

Të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur ata nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;

Të realizojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkisë

Të marrë masat e duhura, duke bashkëpunuar edhe me seksionin e shërbimeve publike me qëllim zbatimin e funskioneve të bashkisë

Numri i punonjësve në këtë sektor është 12 punonjes,shpenzimet për vitin 2025 jane realizuar në masën 100% të planit, krahasuar me vitin 2024 me 129 %.

Programi 03280 "Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri"

Objektivat

1.Organizimi kësaj strukture për garantimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi për komunitetin, blegtorinë, ndërtesat, pyjet dhe kullotat, për parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe përballimin e emergjencave të tjera që vijne nga fenomene të natyrës apo nga veprimtari njerëzore.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 03280

Numri i punonjësve të planifikuar është 16 punonjës.

Shpenzimet janë realizuar në masën 72% të planit, krahasuar me vitin 2024 me 136.4%.

04240 ***"Menaxhimi infrastrukturës së ujitje-kullimit"***

Objektivat:

1.Organizimi i punës për shrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitje kullimit me qëllim rritjen e produkteve bujqësore.

2.Organizimi i sistemit të kontrollit të përmbytjeve.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04240

Ky program funksionon me 38 punonjës plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 84%, krahasuar me vitin 2024 me 88%. Realizim të ulët të planit kemi patur për shkak të kushteve të motit. Punimet dhe investimet do të kryhen gjatë muajve në vazhdim.

04260 ***"Programi pyje - kullota"***

Objektivat:

1.Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimi në mënyrë racionale i pyjeve dhe kullotave.

2.Organizimi dhe marrja e masave për vënien nën kontroll të sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje dhe parandalimin e zjarreve dhe fenomeneve të pa dëshirueshme në pyje.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04260

Ky program funksionon me 30 punonjës, plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 100% , krahasuar me vitin 2024 me 156%. Gjatë vitit 2024 kemi bërë më pak shpenzime operative dhe investime se në vitin 2025.

04520 Rjeti rrugor rural

Objektivat :

1.Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale si rrugë, ura, sheshe publike, trotuare,vepra arti në të gjithë njesitë administrative të Bashkisë Maliq, me qëllim realizimin e lehtësimit të trafikut të mjeteve dhe lëvizjen e lirshme të qytetarëve.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04520

Ky program funksionon me 23 punonjës, plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 99.4 % krahasuar me vitin 2024 me 65%.

06260 Shërbimet publike vendore

Objektivat:

1.Kryerja e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane të 6 njesive administrative ;

2.Mirëmbajtja e të gjithë institucioneve arsimore dhe administrative në shkolla dhe kopshte me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për nxënësit dhe rritjen e cilësisë të mësimdhënies.

3.Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta,trotuareve,varrezave në të gjithë territorin e bashkisë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.

4.Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit dhe mirembajtja e rrjetit ekzistues.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 06260

Ky program funksionon me 190 punonjës, plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 97%, krahasuar me vitin 2024 me 96.2% .

06370 Ujësjellës kanalizime

Objektivat :

1.Sigurimi i furnizimit me ujë të popullsisë të Bashkisë Maliq duke rritur cilësinë e ujit dhe orët e furnizimit nëpërmjet investimeve në ujësjellësa të rinj dhe kanalizime.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 06370

Shpenzimet e planifikuara në këtë program jane investime që kryen Bashkia për ujësjellsa dhe KUZ. Këto jane politikat e bashkisë në drejtim të shërbimeve ndaj komunitetit për te pëmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm të komunitetit dhe menaxhimin e ujrave të zeza.

08220 Shërbimet kulturore

Objektivat:

1.Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore;

2.Organizimi i eventeve kulturore për të pasur një jetë artistike të larmishme gjatë gjithë vitit duke dhënë koncerte,filma dhe shfaqje artistike;

3.Mbrojtja dhe promovimi i biblotekave i ambienteve për lexim në te gjithë njësitë Administrative për të rritur numrin e lexuesve nga të gjitha moshat;

4.Mbështetje dhe funksionim i ambienteve sportive, mbështetje ekipit përfaqësues të bashkisë si dhe ekipeve zinxhir me qëllim masivizimin e sportit, duke i orientuar nxënësit e shkollave drejt sportit dhe aktiviteteve kulturore;

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 08220

Ky program funksionon me 17 punonjës, plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 90%, krahasuar me vitin 2024 me 108.3 % .

Programi 09120 *"Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë"*

Ky program zbatohet me fonde specifike , për pagat dhe sigurimet shoqërore, numri i punonjësve arsimorë dhe mbështetës i planifikuar në fillim të vitit ishte 93 punonjës.
Përvec fondeve specifike për këtë program Bashkia ka planifikuar nga fondet e veta për shpenzime operative për mirembajtje dhe shpenzime për investime kapitale.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 09120

Plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 73.3%. Krahasuar me vitin 2024 me 102%.

Programi 09230 *"Arsimi i mesëm dhe i përgjithshëm"*

Ky program zbatohet me fonde specifike , për pagat dhe sigurimet shoqërore,numri i punonjësve arsimorë dhe mbështetës i planifikuar në fillim të vitit ishte 16 punonjës.
Përvec fondeve specifike për këtë pogram Bashkia ka planifikuar nga fondet e veta për shpenzime operative për mirembajtje dhe shpenzime për investime kapitale.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 09230

Plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 70.8%, krahasuar me vitin 2024 me 57%.
Gjatë vitit 2025 kemi bërë më pak shpenzime operative dhe investime se në vitin 2024.

Programi **10430** ***"Ndihma ekonomike dhe paaftësia"***

Janë programe që përballohen me fonde të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, planifikimi i fondeve bëhet nga ministritë përkatëse dhe realizimi është në përputhje me planin.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 10430

Plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 99%, krahasuar me vitin 2024 me 95%

ANEKSI 3

Referuar aneksit 3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës të produkteve të programit"

Ne lidhje me Aneksin 3 jane plotesuar te gjitha tabelat sipas programeve gjatë gjithë vitit.

ANEKSI 4

"Raporti i realizimit të objektivave të politikës të programit"

Për plotësimin e këtij Aneksi jemi përpjekur të vendosim tregues sa më realë .

ANEKSI 5 paraqet realizimin e investimeve me financim të brendshëm, për vitin 2025 janë investimet e kryera në vitin 2024 dhe janë likuiduar gjatë vitit 2

025, për investimet e vitit 2025 jemi në procedurë prokurimi dhe zbatimi të kontratës.

Treguesit Financiarë

Po të analizojmë treguesit financiarë për vitin 2024 dhe planin 2025 rezulton se:

1. Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme rezulton 95 %, ky tregues është në nivel pozitiv dhe për vitin 2026 mendojmë ta realizojmë 100%;
2. Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme rezulton 11.9%, kjo tregon se pjesa më e madhe e buxhetit varet nga transfertat e qeverisë qendrore, por për vitin 2026 këtë tregues do ta përmirësojmë duke punuar më shumë në drejtim të hartimit të një buxheti sa më real, organizimit të punës dhe futjes të praktikave më të mira.

3. Raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 20.3 %, është një tregues pozitiv dhe gjatë vitit mendojmë ta përmirësojmë.

4. Raporti i shpenzimeve të personelit ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 36.2% dhe për vitin 2025 kemi një ulje me 3.8%. Raporti i shpenzimeve për politikat e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 29.2% , ky është një tregues pozitiv, që vjen jo vetëm nga rritja e numrit të përfituesëve nga skema e re e ndihmës ekonomike, nga rritja e shumës të ndihmës për çdo familje, por është një tregues pozitiv i politikave që ndjek qeveria për të mbështetur këtë kontigjent në nevojë.
5. Detyrimet e prapambetura për vitin 2025 kapin vlerën 75,164,845.2 lekë të cilat janë shpenzime operative dhe shpenzime për investime. Detyrimet per shpenzime operative janë në vlerën 7,720,529 lekë për mallra dhe detyrime për shërbime në vlerën 1,364,270 lekë.

   Detyrimet për investime kapin vlerë 66,080,046.2 lekë të cilat janë për objektet si më poshtë:

   - ''Sistemim asfaltim rrugë viti 2024 faza e II-të në vlerën 5,839,453 lekë për firmën Vashtëmia.
   - ''Ndërtim korsi bicikletash'' në vlerën 4,064,200 për firmën ARTYKA II.
   - ''Sistemim asfaltim rrugë viti 2024'' në vlerën 15,202,445.2 lekë për firmën Rruga Ura Elbasan.
   - ''Sistemim asfaltim rrugë viti 2025'' në vlerën 36,725,616 lekë për firmën Vashtëmia.
   - ''Rikonstruksion palestër Gjimnazi Pirg'' në vlerën 3,300,332 lekë për firmën Nika.
   - ''Ndërtim linje ujësjellësi Goçë'' në vlerën 948,000 lekë për firmën Avdolli.

   Likuidimi i këtyre detyrimeve do të shihet me përparësi gjatë vitit 2026.

Faleminderit!

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

ANEKSI NR. 1

RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

BASHKIA MALIQ

në 000/lekë

Emri i grupit					Kodi i grupit			
Programet		Shpenzimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore						
Titulli	**Emërtimi**	(1) **Fakti i vitit paraardhës Viti 2024**	(2) **PBA Viti 2025**	(3) **Buxheti vjetor Plan Fillestar Viti 2025**	(4 **Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2025**	(5) **Buxheti vjetor Plani i Periudhës/progresiv**	(6) **Fakti i Periudhës/progresiv**	(7)=(6)-(5) **Diferenca**
0001	0 1110	196,479	328,299	329,940	368,286	326,279	315,702	(10,577)
	0 3140	10,010	13,352	13,352	13,352	12,914	12,907	(7)
	0 3280	19,491	27,382	27,382	37,115	36,924	26,578	(10,346)
	0 4220	9,101	-	-	-	-	-	-
0002	0 4240	72,427	94,344	91,700	75,765	75,765	63,615	(12,150)
0003	0 4260	19,663	44,234	40,862	30,922	30,792	30,767	(25)
0004	0 4520	161,444	286,051	160,678	166,874	105,629	104,968	(661)
0005	0 4530		-	-	-	-	-	-
0006	0 4980		2,000	2,000	1,188	670	-	(670)
0009	0 6220		-	-	-	-	-	-
0010	0 6260	200,882	457,536	354,778	231,797	199,788	193,344	(6,444)
0011	0 6370	21,691	16,996	16,996	69,284	62,988	62,986	(2)
	0 8140	22,134	-	6,359	6,359	6,359	6,359	-
	0 8220	16,529	39,500	38,750	20,790	19,952	17,905	(2,047)
0012	0 8250		-	-	-	-	-	-
0013	0 9120	105,750	128,114	128,114	146,911	146,912	107,730	(39,182)
0014	0 9230	26,381	19,697	19,697	21,244	21,244	15,034	(6,210)
	6190	26,848	-	-	14,000	14,000	14,000	-
0015	0 10910	60,054	-	-	44,445	44,445	44,000	(445)
0017	0 1170	8,061	-	-	9,099	9,099	8,944	(155)
	0 1620		-	-	3,028	3,028	3,007	(21)
0018	10430	458,745	-	-	439,357	439,357	435,294	(4,063)
0019	466		-	-	-	-	19,726	19,726
	5100		8,000	8,000	8,000	8,000	8,000	
.....	.....		-	-	-	-	-	
Totali i shpenzimeve të njësisë		**1,435,690**	**1,465,505**	**1,238,608**	**1,707,816**	**1,564,145**	**1,490,866**	(73,279)
Totali		**1,435,690**	1,465,505	1,238,608	**1,707,816**	**1,564,145**	**1,490,866**	(73,279)

Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore		
	Emri	Gëzim Topçiu
	Firma	
	Data	23.01.2026.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS ARTIKUJVE

ne 000/lekë

Bashkia	MALIQ						Kodi i grupit /	....
Programi	BASHKIA MALIQ						Kodi i programit	.....
Art.	Emërtimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	-2 PBA Plan Viti 2025	-3 Buxheti vjetor Plan fillestar viti 2025	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2025	-5 Buxheti vjetor Plani i periudhës/progresiv	-6 Fakti i periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	386,684	721,129	652,359	502,923	508,850	463,456	(45,394)
601	Sigurime shoqërore	65,822	83,077	113,548	89,066	77,303	75,732	(1,571)
602	Mallra dhe shërbime të tjera	171,331	301,732	215,994	223,339	186,247	163,270	(22,977)
603	Subvencione	-	-	-	-	-	-	-
604	Transferta korrente të brendshme	20,608	-	16,354	25,682	24,604	24,153	(451)
605	Transferta korrente të huaja	-	-	-	-	-	-	-
606	Trans për buxh. fam. & individ	461,444	-	5,620	445,816	445,626	441,364	(4,262)
609	Fondi rezerve + emergjencat civile		-	2,000	1,188	670		(670)
466		3,726	-				19,726	
Nëntotali	*Shpenzime korrente*	***1,109,615***	***1,105,938***	***1,005,875***	*1,288,014*	*1,243,300*	*1,187,701*	(55,599)
230	Kapitale të patrupëzuara	2,358	-	1,100	7,615	7,030	4,712	(2,318)
231	Kapitale të trupëzuara	323,717	359,567	231,633	412,187	313,815	298,453	(15,362)
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Nëntotali	***Shpenzime kapitale me financim të brendshëm***	*326,075*	*359,567*	***232,733***	*419,802*	*320,845*	*303,165*	(17,680)
230	Kapitale të patrupëzuara							-
231	Kapitale të trupëzuara							-
232	Transferta kapitale							-
Nëntotali	***Shpenzime kapitale me financim të huaj***							-
Totali	Shpenzime kapitale	**326,075**	**359,567**	**232,733**	419,802	320,845	303,165	(17,680)
Totali (korrente + kapitale)		**1,435,690**	**1,465,505**	**1,238,608**	1,707,816	1,564,145	1,490,866	(73,279)

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri Almira Muka	**Kryetari i Njësisë Vetëqeverisjes Vendore**	Emri	Gëzim Topçiu
	Firma		Firma	
	Data: 23.01.2026		Data	23.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ